



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:010995
Datë: 04.06.2018
Numri i dokumentit: 00058991

P.nr.733/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. Rr. nga Gjakova, shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë–Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.nr.855/2017, të datës 30.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 04.06.2018, në prezencën e Prokurorit të shtetit Enis Gashi si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F. RR., nga i ati T., e ëma Z., e gjinisë R., data e lindjes . . . , në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën ..., i martuar, baba i 6 (gjashtë) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon si punëtorë krahu, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:.....

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse nga data e pavërtetuar e deri me datën 06.02.2017, në lokalitetin e tij N.P.T.H “Rr.” në fshatin O. P., Komuna Gjakovë, me qëllim që vetit të sjellë përfitim pasurore të kundërligjshëm me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit nr.5/L-085 të Ligjit për Energji Elektrike të GZRK nr.26/21, Korrik 2016, në atë mënyrë që jashtë njësorit elektrik me nr... përmes kabllorës 5x6 të cilën përmes ndërprerësit 1-0-2 ka bërë lidhje direkt në kuadrin kyçës kryesor (KKK) të njësorit elektrik duke penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të D. në Gjakovë me rastin e kontrollës, me ç ‘rast të dëmtuarën K.-D.-D. në Gjakovë i shkaktonte dëm rreth 3,697.81 Euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe nenit 320 të KPRK-së, të akuzuarit ia shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) Euro dhe duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara K.-D. në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej 40 (dyzet) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.855/2017, të datës 30.10.2017, kundër të akuzuarit F. Rr. nga Gjakova, për shkak te veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Enis Gash, gjatë shqyrtimit fillestar ka bërë përmirësimin e përshkrimit faktike të aktakuzës me numër PP/II.nr. 855/17, të datës 30.10.2017, duke deklaruar se bëjë përmirësimin e përshkrimit faktik ashtu që në rreshtin e fundit ku është shënuar i ka shkaktuar dëme në vlerë prej 3.697.81 Euro, duhet të jetë i ka shkaktuar dëme rreth 3.697.81 Euro, meqenëse nuk kemi ndonjë ekspertizë të veçantë nga ndonjë organ të pavarur dhe akuzuari paraprakisht u deklarua se e konteston vetëm shumën, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar. Prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit fillestar ka mbetur në tërësi pran aktakuzës kundër të akuzuarit F. Rr. andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari F. Rr., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës, se është penduar për këtë veprim dhe gjykatës i ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla duke shtuar se kundërshtoj shumën e dëmit që është caktuar nga ana e K. ngase nuk është reale.

Prokurori i shtetit Enis Gash, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe provat dhe në faktet që janë bashkangjitur aktakuzës.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Sepse nga data e pavërtetuar e deri me datën 06.02.2017, në lokalitetin e tij N.P.T.H “Rr.” në fshatin O. P., Komuna Gjakovë, me qëllim që vetit të sjellë përfitim pasurore të kundërligjshëm me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit nr.5/L-085 të Ligjit për Energji Elektrike të GZRK nr.26/21, Korrik 2016, në atë mënyrë që jashtë njësisë elektrike me nr.... përmes kabllorës 5x6 të cilën përmes ndërprerësit 1-0-2 ka bërë lidhje direkt në kuadrin kyçës kryesor (KKK) të njësisë elektrike duke penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të Distriktit në Gjakovë me rastin e kontrollës, me ç’rast të dëmtuarën K.-D. i Rr.-D. në Gjakovë i shkakton dëm rreth 3,697.81 Euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimit i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i 6 (gjashtë) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, mbajtës i familjes prej 8 (tetë) anëtarësh, të ardhurat i siguron kryesisht si punëtor krahu, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimit e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij duke shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtilla, do të jetë më i kujdesshëm, faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimin i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësorë është marrë konform nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.733/17, me datë 04.06.2018

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.